

BEQIR META**ÇËSHTJA E SHKOLLAVE TË MINORITETIT GREK
NË VITIN 1934**

Në vitin 1934 pas shtetëzimit të shkollave private nga qeveria shqiptare u krijua një tension i ri në marrëdhëniet me Greqinë dhe me minoritetin grekofon. Shtetëzimi kishte karakter të përgjithshëm për të gjitha shkollat private në Shqipëri. Ai synonte vendosjen e arsimit nën kontrollin dhe drejtimin e shtetit dhe shmangien e ndërhyrjeve të huaja në sistemin arsimor shqiptar, të cilat kishin pasur efekte negative në formimin e nxënësve shqiptarë me një edukatë kombëtare. Edhe pas shtetëzimit shkollat vijuan mësimet në gjuhën greke me tekstet e mëparshme, por fillimisht orët e mësimit në gjuhën greke u reduktuan. Mbreti Zog e mbajti premtimin që i kishte dhënë ministrit grek, duke emëruar në shkollat e shtetëzuara të minoritetit grek mësues që të gjithë kishin diploma greke por kjo nuk e kënaqi Athinën, e cila synonte të ruante ndikimin e vet politik tek mësuesit e këtyre shkollave. Prandaj ajo do ta shndërronte këtë çështje në një betejë të ashpër politike me Tiranën. Edhe ministri britanik në Tiranë, Hodgson mendonte se kjo zgjidhje nuk i pëlqente Athinës, pasi grekët dëshironin që këto mësues të caktoheshin prej tyre. Ata i mbështesnin pretendimet e veta në deklaratën e qeverisë shqiptare para Lidhjes së Kombeve (LK) në vitin 1921.

Fillimisht vendimi i qeverisë shqiptare për shtetëzimin e shkollave të minoritetit grek nuk shkaktoi reagime. Madje, komentet fillestare të ministrit britanik Hodgson ishin në favor të masave që kishte marrë qeveria shqiptare. Ai mendonte se Deklarata shqiptare e vitit 1921 nënvizonte trajtimin e pakicave në mënyrë të barabartë me shumicën e popullsisë, kështu që nuk kishte ndonjë arsye të shëndoshë që pakica grekofone të mbante shkolla me një status tjetër. Sipas tij, i vetmi argument që kishin parashtruar grekët, ishte *status quo*-ja e krijuar tashmë, e cila nuk mund të modifikohet në mënyrë të njëanshme. Por, edhe këtë argument ministri britanik e konsideronte të dobët, aq më tepër kur shqiptarët mund të pretendonin në mënyrë bindëse se mësuesit komunalë ishin paguar në të kaluarën nga fonde që kishin ardhur prej

burimeve greke, për qëllime propagandistike dhe së dyti, nuk mund të diskutohej që ata t'u bënin ndonjë lëshim grekëve, pasi ky lëshim duhej tu bëhej pastaj edhe subjekteve të tjera. Kështu që, qeveria greke nuk kishte ndonjë alternativë, por duhej të pranonte zgjidhjen e dhënë nga shqiptarët, megjithëse asaj mund të mos i pëlqente.¹

Reagimi i grekëve erdhi në fillim të vitit 1934, kur banorë nga pakica greke në Shqipëri i dërguan Sekretariatit të LK një peticion² në të cilin ankoheshin se “Shqipëria, duke manifestuar qëllimin për të zhdukur tërësisht gjuhën greke, ka marrë masa restriktive të lirive tona shkollore. Nga 90 mësues grekë vitin e kaluar ajo lejoi vetëm 11 mësues të jepnin gjuhën greke, autoritetet kanë vonuar, nganjëherë me muaj të tërë, hapjen e shkollave greke, duke refuzuar pa asnjë motiv aprovimin e emërimit të mësuesve të caktuar nga komuniteti; kanë kërkuar që këta mësues të dinin gjuhën shqipe dhe i kanë marrë ata në provim, me qëllimin e vetëm për të larguar ata që i rezistonin dhunimit të të drejtave minoritare; kanë futur në mënyrë të detyrueshme mësimin në shqip të të gjitha lëndëve të mësimin, duke lënë vetëm disa orë në javë për mësimin e gjuhës greke; kanë ndaluar nxënësit të flasin gjuhën e tyre gjatë kohës së pushimeve dhe kanë ndaluar këngët greke; duke zbatuar ligjin për shkollat private, është ndaluar tërësisht funksionimi i shkollave greke gjatë vitit shkollor në vijim; për më tepër, ata kanë ndaluar edhe përdorimin e gjuhës greke në kisha; autoritetet shqiptare nuk kanë lejuar banorët grekofonë të ankohen tek Mbreti Zog por i kanë kërcënuar, burgosur dhe internuar ankuesit”.

Në fakt, nga e gjithë kjo mori ankesash vetëm njëra dukej se ishte e arsyeshme: qeveria shqiptare kishte reduktuar orët e mësimin në greqisht, duke i zëvendësuar me mësimin në gjuhën shqipe. Gjithashtu, reforma fillimisht ishte zbatuar në mënyrë të nxituar, pa u përgatitur mirë dhe kishte krijuar vështirësi. Më vonë këto gabime do të ndreqeshin, por grekët i shfrytëzuan ato me mjeshtëri për ta vënë qeverinë shqiptare në një pozitë të vështirë.

¹ *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), Public Record Office, Foreign Office (më tej: *FO*) FO 371/18339. Sër R. Hodgson nga Durrësi për Sër John Simon, 24 janar 1934.

² *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti (më tej: *V.*) 1934, dosja (më tej: *D.*) 255, fl. 59, 112-114. Lec Kurti drejtuar ministrit të Jashtëm Xhaferr Vila, 7 prill 1934.

Disa muaj më vonë, R. Hodgson zbulonte edhe rrugën që kishte ndjekur miratimi i këtij peticioni. Ai njoftonte Foreign Office (FO) se peticioni, i cili ishte nënshkruar nga 1000 persona, ishte qarkulluar në mënyrë sekrete në shtatë qendra grekofone.³

Një ankesë të ngjashme i parashtrroi Unionit Ndërkombëtar të Shoqatave për Lidhjen e Kombeve edhe Shoqata Helenike në shkurt të vitit 1934. Më datë 19-24 maj 1934, Asambleja e këtij Unioni miratoi një rezolutë, e cila pohonte se masat e marra nga qeveria shqiptare kishin pasur si qëllim suprimimin e mësimit të gjuhës amtare greke, një e drejtë e njohur nga Deklarata e Shqipërisë e vitit 1921⁴.

Në prill 1934, Sekretari i LK i dërgoi qeverisë shqiptare peticionin e minoritetit grek dhe kërkoi një përgjigje prej saj. Në qershor të vitit 1934, qeveria greke e vijoi aksionin e saj duke u përpjekur të ndikonte tek ministri britanik në Shqipëri. Me porosi të saj, ministri grek në Tiranë, Diamantopoulos takoi Hodgsonin dhe i kërkoi atij që të ndikonte për të bindur anëtarin britanik në Komitetin e Minoriteteve për drejtësinë e pretendimeve greke.⁵

Gjithashtu, edhe ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Xhaferr Vila u përpoq të sqaronte ministrin britanik për qëndrimin e qeverisë së tij. Ai i tha Hodgson-it se kërkesa e bërë nga Gjeneva në prill 1934 për shqyrtimin e kësaj çështjeje po diskutohej dhe pas pak ditësh do të jepej një përgjigje. Ai shprehu dyshime për karakterin spontan të propagandës që po zhvillohej midis grekofonëve dhe tha se ishte i sigurt që peticioni e kishte origjinën e tij në Athinë. Konsulli grek në Gjirokastrë ishte organizatori i gjithë këtë propagande dhe këtij aksioni që kishte krijuar konfliktin e tanishëm. Ministri i Jashtëm shqiptar i kishte tërhequr vëmendjen ministrit grek për këtë aktivitet të gabuar të vartësit të tij. Ai hodhi poshtë kategorikisht pretendimin grek se sistemi i krijuar më parë, ku pleqësitë e fshatrave emëronin dhe paguanin mësuesit, kishte fituar qëndrueshmëri. Xh. Vila gjithashtu i deklaroi përfaqësuesit britanik se qeveria shqiptare ishte shumë e vendosur të respektonte detyrimet e marra në vitin 1921 por, ishte çështje e saj se si dhe nga kush do të zbatohet ky detyrim. Ai u përpoq të bindte Hodgson-in se niveli

³ TNA, FO 371/18339. Sër R. Hodgson nga Durrësi për Sër John Simon, 13 qershor 1934.

⁴ AMPJ, V. 1935, D. 183, fl. 166.

⁵ TNA, FO 371/18339. Sër R. Hodgson nga Durrësi për Sër John Simon, 13 qershor 1934.

profesional i mësuesve të emëruar në shkollat e reja ishte i kënaqshëm. Por, kur Hodgsoni i tha se, ministri i Arsimit Publik nuk kishte treguar shumë entuziazëm për zbatimin e deklaratës që qeveria e tij kishte bërë në Gjenevë, Xhaferr Vila nuk bëri ndonjë koment për këtë çështje por vetëm shtoi se “dikasteri i tij kishte ndjekur një politikë të moderuar dhe të qëndrimit miqësor, pasi ai e kishte plotësisht të qartë që Shqipëria vetëm do të humbiste nga konfliktet e vogla me fqinjët e saj.”⁶

Qeveria greke dhe përfaqësuesi i saj në Tiranë, Diamantopulosi e shikonte çështjen e shkollave nga një këndvështrim krejt tjetër. Ai i kishte thënë Hodgsonit se 30-40 mijë grekofonë në Shqipërinë e Jugut kishin vetëm një gjuhë amtare-gjuhën greke. Kështu ishte monstruoze që edukimi i tyre të bëhej në gjuhën shqipe dhe vetëm pak orë mësimi në javë të zhvilloheshin në gjuhën greke. Ai, gjithashtu, nuk i konsideronte si kompetentë mësuesit e zgjedhur nga Ministria e Arsimit. Ai i cilësoi “thjesht gjepura” propozimet e Mbretit Zog për të gjetur një mënyrë që të zgjidheshin mosmarrëveshjet. Sipas përfaqësuesit grek, “Zogu asnjëherë nuk kishte pasur as dëshirën më të vogël për të ndihmuar. Interesi i tij për edukimin e shqiptarëve të Çamërisë ishte shfaqur pasi ai besonte se qeveria greke nuk do të pranonte kurrë detyrimin që të hapte shkolla shqiptare për këtë popullsi”. Diamantopulos e mohoi deklaratën që i kishte bërë në takimin e mëparshëm Hodgson-it se Athina ishte e përgatitur që të hapte shkollat shqiptare për minoritetin çam në qoftë se shqiptarët binin dakord që të rikthenin sistemin arsimor, ashtu siç kishte qenë në vitin 1930.⁷ Në vitet 1928-1930, qeveria shqiptare kishte marrë masa për të futur mësimin e gjuhës shqipe dhe për zhvillimin e orës së historisë dhe gjeografisë së Shqipërisë në shkollat e minoritetit grek por këto masa nuk ishin zbatuar me korrektesë nga mësuesit e shkollave grekofone të cilët i kishin rezistuar këtij programi.

Në qershor 1934 edhe ministri britanik ndryshoi mendim lidhur me vlerësimet e mëparshme që u kishte bërë masave të marra nga qeveria shqiptare. Hodgsoni gjykonte se shqiptarët, nëpërmjet “shovinizmit” të tyre të pakalkuluar mirë, e kishin vendosur veten në një pozitë të gabuar, pasi e kishin të vështirë të pohonin se për shumë vite në të shkuarën ata i kishin hequr privilegjet e mësimin në gjuhën greke, kur deklarata e tyre që ishte bërë në Gjenevë, ishte e freskët dhe ua kishte akorduar këto të drejta

⁶ *Po aty.*

⁷ *Po aty.*

grekëve në mënyrë gjeneroze. Ai e vlerësonte veprimin e Mirash Ivanajt si pikën kulmore në këtë çështje dhe nënvizonte se ai duhej të ishte treguar më i zgjuar. Ai nuk duhej ta kishte ndërmarrë këtë veprim drastik lidhur me shkollat e minoritetit grekofon dhe duhej ta kishte shmangur këtë debat, duke krijuar lehtësi për mësimin e greqishtes, në një shkallë të tillë “sa t’u kishte hequr grekëve armët e luftës”. Ky qëndrim e kishte ekspozuar qeverinë e tij ndaj protestave legjitime të atyre që u ishte shkëlur e drejta për të përdorur gjuhën e tyre.⁸ Në kritikën e ministrit britanik ka diçka racionale që duhet nënvizuar.

Siç e kemi theksuar edhe më lart, gabimi i vetëm dhe me një frymëzim të qartë nationalist i Ivanajt ishte reduktimi i orëve të mësimin në gjuhën greke në shkollat e minoritetit. Megjithatë qeveria shqiptare do ta korrigjonte shpejt këtë gabim, propaganda greke do të përfitonte shumë prej tij, për ta paraqitur gjendjen me ngjyra dramatike dhe politikën shqiptare si një rrezik për asimilimin dhe shkombëtarizimin e minoritetit grek. Reduktimi i orëve të mësimin në gjuhën greke ishte një nga premiset që ndikoi edhe në paragjykimin e masës së përgjithshme dhe të drejtë ligjore që kishte marrë shteti shqiptar për shtetëzimin e arsimit privat në gjithë territorin e vendit.

Por, në anën tjetër, Hodgson-i pohonte se mënyra e parashtrimit të çështjes nga Athina nuk meritonte një simpati të plotë. Pikë së pari, ishte e vështirë që të besohej se zemërimi që kishte shpërthyer në shtypin dhe publikun grek buronte nga ndjenjat e një altruizmi të kulluar. Së dyti, grekët nuk kishin treguar asnjë prirje që të zbatonin për shqiptarët e Çamërisë të njëjtat parime të cilat po i propagandonin me shumë energji. Diamantopulosi ishte munduar të justifikojë në një mënyrë disi të pandershme para tij për këtë politikë shoviniste të qeverisë greke. Ai i kishte thënë ministrit britanik se, kur ishte diskutuar çështja për lejimin e shkollave të minoriteteve kombëtare, një konsideratë e cila kishte peshuar rëndë për qeverinë e tij, kishte qenë reagimi negativ i Jugosllavisë ndaj një zgjidhjeje liberale të kësaj çështjeje. Serbët do ta shihnin atë si një demonstrim të dobësisë dhe do të zemëroheshin. Hodgsoni arrinte në përfundimin se grekët ishin shumë të përgatitur që në Gjenevë të vepronin për të detyruar shqiptarët të zbatonin angazhimin që ata kishin marrë përsipër për t’u akorduar një trajtim të privilegjuar grekofonëve në Shqipëri, por nuk ishin aspak të predispozuar për të ndërmarrë një veprim

⁸ *Po aty.*

të ngjashëm kundrejt minoriteteve të tyre nga frika se, po të vepronin kështu, ata mund të fyenin fqinjët, qëndrimi mospërfillës i të cilëve ndaj detyrimeve për respektimin e të drejtave të minoriteteve, ishte i njohur.⁹

Në korrik të vitit 1934, qeveria shqiptare iu përgjigj zyrtarisht Sekretarit të Përgjithshëm të LK lidhur me letrën që ky i kishte dërguar në prill mbi peticionin e disa grekofonëve të Shqipërisë¹⁰. Në përgjigjen shqiptare pohohej se Shqipëria i kishte zbatuar me korrektesë ligjet ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve, jo vetëm për arsye parimore, por edhe sepse jashtë kufijve të saj kishin mbetur shumë popullsi shqiptare dhe nuk mund të shpresohej që të drejtat e tyre të mbroheshin në mënyrë tjetër, përveç respektimit të marrëveshjeve për mbrojtjen e minoriteteve nga Lidhja e Kombeve.

Qeveria shqiptare në fillim të përgjigjes së saj e trajtonte çështjen në planin historik, duke atakuar pretendimin grek se kishte mbyllur më parë 350 shkolla greke në Shqipërinë e Jugut. Ajo vinte në dukje se gjatë sundimit të Perandorisë Osmane të gjitha popullsitë ortodokse të racave e të gjuhëve të ndryshme të Gadishullit Ballkanik ishin grumbulluar nën emrin “rum” dhe ishin lënë nën varësinë e Patrikatit greko-ortodoks të Kostandinopojës. Kjo krijoi një konfuzion, i cili çoi në luftën e popujve jogrekë kundër Patrikatit, luftë e cila çoi në emancipimin e kishës e të shkollave kombëtare dhe në forcimin e ndjenjave kombëtare. Patrikati, duke përfitur në atë kohë nga toleranca në vazhdim e shtetit osman dhe me subvencione të huaja, organizoi arsimin grek në Shqipëri. Por, me gjithë persekutimin e autoriteteve turke, populli shqiptar, paralelisht me popujt bullgar e serb, u ngrit për të afirmuar ekzistencën kombëtare për arsimin dhe gjuhën amtare.

Gjatë periudhës osmane në Shqipëri kishte 350 shkolla greke, frekuentuesit e të cilave ishin në shumicë ortodoksët shqiptarë, megjithëse një numër i madh i tyre gjendeshin në territoret që më vonë iu aneksuan Greqisë, si Preveza dhe Epiri. Pikërisht, duke u bazuar në këtë argument, një pjesë e minoritetit grek, duke pretenduar të shkuarën, që kishte vdekur për të mos u kthyer më kurrë, po bëhej përkrahëse e propagandës së huaj shkollore.

⁹ TNA, FO 371/18339. Sër R. Hodgson nga Durrësi për Sër John Simon, 13 qershor 1934.

¹⁰ AMPJ, V. 1934, D. 255, fl. 142-145. Ministri i Jashtëm i Shqipërisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Josephe Avenol, Tiranë, 23 korrik 1934.

Ministria e Jashtme shpjegonte se qeveria shqiptare kishte marrë masa për shtetëzimin e gjithë ndërtesave shkollore, duke aplikuar një program unitar të arsimit dhe kishte mbajtur në të gjitha shkollat e fshatrave grekofonë arsimimin në gjuhën amtare greke, siç kishte qenë më parë. Orët kushtuar mësimi greqisht nuk ishin zvogëluar dhe ishin 6-7 orë në javë. Librat e shkollave ishin të njëjta me ato që përdorshin më parë.

Në përgjigjen e qeverisë shqiptare thuhej se disa mësues që kishin qenë më parë nuk ishin marrë në punë përsëri sepse nuk kishin nivelin intelektual që kërkonte ligji dhe se standardi i jetesës së tyre ishte tërësisht në disproporcion me subvencionin modest që kishin vënë në dispozicion fshatarët. Autoritetet shqiptare ishin të bindur që mjetet e tyre të ekzistencës rridhnin nga një burim i huaj. Në kundërshtim me pretendimet e peticionit, Ministria e Punëve të Jashtme pohonte se kishte hapur shkolla fillore edhe në fshatrat me më pak se 25 nxënës, siç e kërkonte ligji. Pranohej se qeveria shqiptare nuk dëshironte të toleronte që në këto shkolla të këndohej çdo ditë himni nacional grek dhe këngët patriotike helene pasi do të krijoheshin pengesa në shkrirjen e ndjenjave nacionale.

Në përgjigjen shqiptare mohohej kategorikisht se në kishat e pakicës greke ishte penguar meshimi në greqisht, ndërsa për kishat e ortodoksëve shqiptarë Kisha Autoqefale Shqiptare, nëpërmjet attributeve të saj legale, kishte vendosur prej shumë vitesh, futjen e gjuhës shqipe.

Nota shqiptare pohonte se me këto masa, qeveria shqiptare kishte pasur si qëllim rregullimin uniform të arsimit publik, duke i dhënë fund indisiplinimit kulturor të trashëguar nga regjimi i kapitulacioneve të vjetra, i cili donte ta bënte Shqipërinë vatër të propagandës së huaj.

Qeveria shqiptare gjykonte se ligjet ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve nuk kishin ndonjë obligim, që një shtet t'u akordonte minoriteteve një trajtim superior në raport me shumicën, në bazë të një ligji të përgjithshëm e mbi të gjitha, kur reciprociteti po u refuzohej minoriteteve shqiptare në vendet e tjera¹¹.

¹¹ *Po aty.*

Për të provuar se sistemi i shkollave shtetërore nuk kishte prekur mësimin e gjuhës dhe kulturës greke, qeveria shqiptare jepte edhe një listë të librave në përdorim në atë kohë nga këto shkolla.*

Në përgjigjen shqiptare ishin paraqitur edhe disa tabela statistikore, të cilat provonin se si kishte ndryshuar raporti i shkollave private dhe shtetërore në zonën e minoritetit. Qeveria shqiptare, duke dashur të ilustronte sakrificat financiare që kishte bërë shteti shqiptar për zhvillimin e arsimit grek në zonën e minoritetit, jepte këtë tablo krahasuese të shkollave shqiptare e greke së bashku me shpenzimet e tyre:

Shqipëria	Prefektura e Gjirokastrës	
	Shqiptare	Gjithë grekofonët e Shqipërisë
I. Popullsia 1.085.000	122.000	18.000
II. Fshatrat 2.534	271	Numri që figuron në peticionin 71
III. Shkolla 557	103	45
IV. Mësues 1.121	151	70
V. Arsim i detyrueshëm i fëmijëve, 10% e popullsisë 100.850	10% e popull. 12.200	Nga 10% e popullsisë 1.800
VI. Totali i rrogave 1.600.000 fr ari	-----	121.850 fr. ari
VII. Proporcioni i nxënësve për çdo shkollë 181,33	118,46	40

Siç rezulton nga statistika e mësipërme, proporcioni i shkollave, i mësuesve dhe i shpenzimeve, që ishin 20% për shqiptarët dhe 63% për grekofonët, tregon qartë avantazhin e popullsisë grekofone.

Për të provuar se mjetet e nevojshme që dispononin disa fshatra grekofone për të mbajtur shkollat greke ishin modeste, në notën shqiptare jepeshin këto të dhëna:

Fshatrat	Banorët
1. Radat	47 banorë, kishte një shkollë
2. Tremoli	37 banorë një shkollë
3. Kasem Ali Bej	45 banorë një shkollë
4. Metoq	35 banorë një shkollë

* *Gramatikë e gjuhës amtare*, 1902; *Letërsia greke moderne*, Patris, viti 1-rë, pjesa e 1-rë, 1921; *Letërsia greke moderne*, Patris, viti i 1-rë, pjesa e dytë, 1920; *Letërsi – Babai i mirë* (O Kalos Patir) i Jean Vretou 1895; *Biblioteka e shkollës rurale*, nga Jean Tariq, vëllimi i 1-rë. Të gjitha ishin botuar në Librarinë Cheytanidhi, rruga Mahmudiye në Gallate, Kostandinopojë.

5. Vromero	65 banorë një shkollë
6. Adhrosove	96 banorë një shkollë
7. Qemuraj	91 banorë një shkollë
8. Mavropol	34 banorë një shkollë
9. Shinjani	31 banorë një shkollë
10. Dermishi	48 banorë një shkollë
11. Mavroha	88 banorë një shkollë

Ndërsa qeveria shqiptare po përpiquej të justifikonte masat e saj, grekët ishin në ofensivë për të imponuar kërkesat e tyre. Në tetor të vitit 1934, Sekretarit të Përgjithshëm të LK iu dërgua një ankesë tjetër në të cilën pohohej se fillimi i vitit të ri shkollor, jo vetëm që nuk kishte sjellë ndryshime, por i gjithë minoriteti nuk kishte denjuar të dërgonte fëmijët në shkollat shtetërore, duke menduar se të drejtat e tyre ishin dhunuar dhe se autoritetet shqiptare kishin reaguar duke arrestuar e internuar disa banorë. Ky peticion ishte firmosur nga 4 vetë në fshatin Leshnicë e Sipërme, përmbante 15 firma të tjera, pa datë dhe pa përcaktuar fshatin; kishte dy firma nga Dibra dhe një firmë nga Delvina, pra ishte mjaft i dyshimtë¹².

Më 5 tetor, Presidenca e Lidhjes Helene pro Lidhjes së Kombeve iu drejtua Bashkimit Ndërkombëtar të Shoqatave për Lidhjen e Kombeve me një komunikatë, në të cilën akuzoheshin autoritetet shqiptare se vazhdonin të pengonin rihapjen e shkollave minoritare dhe se situata e minoritetit grek, në vend që të përmirësohej pas ndihmës që kishte dhënë Lidhja e Kombeve, ishte keqësuar më tej dhe se ndaj minoritetit po ushtrohej dhunë¹³. Sekretari i Përgjithshëm i Unionit Ndërkombëtar të Shoqatave për LK ia parashtrroi këtë komunikatë Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, J. Avenol dhe kërkoi mbështetjen e kërkesës së tij¹⁴.

Situata e krijuar u vlerësua si emergjente nga përfaqësuesi britanik në Lidhjen e Kombeve, Rosting i cili i kërkoi Foreign Office që Komiteti i Minoriteteve i LK të mblidhej urgjentisht, me qëllim që të kishte mundësi ta paraqiste çështjen para takimit të jashtëzakonshëm të Këshillit që do të

¹² *AMPJ*, V. 1934, D. 255, fl. 216-217.

¹³ *Po aty*, V. 1934, D. 255/1, fl. 54-55. Shoqëria Helenike për Shoqërinë e Kombeve drejtuar Th. Ruysen, sekretar i Përgjithshëm i Unionit Ndërkombëtar të Shoqatave për Lidhjen e Kombeve, Athinë, 5 tetor 1934.

¹⁴ *Po aty*, V. 1935, D. 183, fl. 168. Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatave për Lidhjen e Kombeve, Th. Ruysen, për J. Avenol, Gjenevë, 6 tetor 1934.

zhvillohej më 15 nëntor 1934. Ai mendonte se vetë kjo mbledhje e jashtëzakonshme e Komitetit të Minoriteteve mund të kishte një ndikim qetësues tek autoritetet shqiptare dhe në opinionin publik në Greqi.¹⁵

Komiteti i Minoriteteve u mbledh më 16 tetor 1934 dhe, në kundërshtim me propozimin e përfaqësuesit britanik, vendosi që çështja të mos konsiderohej si një çështje e zakonshme minoritare por një zhvillim i vështirësive politike midis qeverive greke dhe shqiptare i cili po zgjaste prej një kohe të gjatë dhe, kështu, për këtë çështje duhej vepruar me kujdes. Komiteti vendosi që të vijonte ekzaminimin e peticionit të grekofonëve në një mënyrë të zakonshme. Ai do t'i kërkonte drejtorit të Seksionit të Minoriteteve të informonte gojarisht përfaqësuesin grek se Komiteti kishte shqyrtuar shpjegimet e dhëna nga qeveria shqiptare dhe t'i tregonte atij se ajo do të vepronte në një mënyrë që do të siguronte qetësinë në rajon.¹⁶

Përfaqësuesi britanik në Athinë, A. Walker njoftonte Londrën se, kohët e fundit, shtypi i Athinës kishte propaganduar me forcë trajtimin represiv të popullsisë grekofone të Shqipërisë. Në këto gazeta përsëritej njoftimi se autoritetet shqiptare, duke mos u kënaqur me mbylljen e shkollave greke në Epirin e Sipërm, po merrnin masa të tjera shtrënguese, si vendosja e policisë jashtë konsullatës greke në Gjirokastër e cila kishte arrestuar persona që kishin shkuar të merrnin viza për në Greqi dhe, gjithashtu, kishin mbyllur kufirin greko-shqiptar.

Çështja e shkollave u diskutua edhe në Parlamentin Grek. Ministri i Jashtëm grek deklaroi se çështja po shqyrtohej nga Lidhja e Kombeve dhe shpresohej në marrjen e një vendimi. Ai pohoi se qeveria greke nuk kishte munguar të bënte përpjekjet e nevojshme pranë qeverisë shqiptare, veçanërisht për shkollat greke e cila kishte dhënë siguri se do t'i zgjidhte çështjet. Ai shpresonte se ajo do ta mbante fjalën dhe do të respektonte angazhimin që kishte marrë para Lidhjes së Kombeve. Kjo deklaratë nuk kënaqi shtypin grek, i cili po bënte presion që qeveria greke të denonconte Marrëveshjen Tregtare greko-shqiptare të nënshkruar në prill të atij viti.¹⁷

¹⁵ TNA, FO 371/18339. Përfaqësuesi britanik në LK, Rosting, për W. E. Beckett në Foreign Office, Gjenevë, 6 tetor 1934.

¹⁶ Po aty, FO 371/18339. Shënime nga takimi i Komitetit të Minoriteteve, 16 tetor 1934.

¹⁷ Po aty, FO 371/18339. A. Walker nga Athina për John Simon në Foreign Office, 18 tetor 1934.

Situata e krijuar preokupoi edhe qeverinë britanike. Foreign Office e diskutoi çështjen e marrjes së një qëndrimi ndaj këtij konflikti por, zyrtari i lartë britanik O. Sargent sugjeroi se do të ishte më mirë që çështja t'i lihej Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Në shënimet e tij, ai theksonte se, nuk pëlqente shumë që të ndërhynte në një çështje, kur ajo, tashmë, ishte në duart e Lidhjes. “Ne nuk kemi *locus standi* [atribut] për të ofruar këshilla dhe, në se ne e bëjmë këtë, të dy palët, si grekët ashtu dhe shqiptarët, do të na akuzojnë se po mbajmë qëndrim të njëanshëm ndaj kësaj çështjeje. Kështu ne do të mbytemi nga shpjegime dhe akuza prej të dy palëve”, shkruante ai. Nga ana tjetër, ai shprehej plotësisht dakord se të dy qeverive u duhej bërë një paralajmërim që të tregoheshin të përmbajtura, përderisa çështja ishte ende në gjykim. Ky paralajmërim duhej të bëhej nga një gjykatë dhe jo nga njëri prej anëtarëve të jurisë, duke supozuar se çështja do të shkonte para saj, domethënë para Këshillit. Ai propozonte që qeveria britanike t'i komunikonte, jo zyrtarisht, Sekretariatit të LK raportet që ajo kishte marrë për sjelljen e keqe të dy palëve. Kështu, Komiteti i të Treve, i cili po merrej me çështjen, mund t'u drejtonte paralajmërimet të përshtatshme të dy palëve në emër të Lidhjes së Kombeve, në qoftë se ai e mendonte të dobishme. Në këtë mënyrë, ai sugjeronte që përfaqësuesit britanikë në Durrës dhe në Athinë, të mos angazhoheshin¹⁸.

Ndërkohë, përfaqësuesi britanik në Shqipëri Weld-Forester vijoi diskutimet me ministrin grek Diamantopulos i cili, në bazë të udhëzimeve të qeverisë së tij, sapo kishte bërë një udhëtim në zonat e minoritetit. Diamantopulos i tha atij se gjërat po shkonin shumë keq dhe nuk e kishte fshehur zemërimin e tij kundrejt politikës së qeverisë shqiptare për çështjen e shkollave dhe për pozitën e përgjithshme të Epirit të Veriut. Ministri grek kishte përsëritur të njëjtat akuza dhe kishte përdorur të njëjtën gjuhë edhe në bisedat që kishte zhvilluar me misionet e tjera diplomatike në Shqipëri. Opinioni i tij ishte se, në të kaluarën, ishte krijuar një *status quo*, e cila nuk mund të modifikohet në mënyrë të njëanshme. Udhëzimet e reja të ministrit shqiptar të Arsimit që parashikonin një minimum prej 6 orësh greqisht në javë në të gjitha shkollat greke, ai i kishte hedhur poshtë kategorikisht si të papërshtatshme. Ai ishte ankuar se propozimi që i kishte bërë Fuat Asllani, Maximosit në Gjenevë për shkollat e minoritetit, të cilat do të

¹⁸ *Po aty*, FO 371/18339. Shënime të O. Sargent, 26 tetor 1934.

zhvillonin 4 orë mësim greqisht në ditë, duke përfshirë të gjitha mësimet në gjeografi dhe histori, nuk ishte përfshirë në udhëzimet e reja. Në fakt, Fuat Asllani i kishte folur edhe ministrit britanik për këtë propozim që i kishte bërë Maximos-it në Gjenevë, por, kishte shtuar se ministri i Jashtëm grek nuk e kishte pranuar dhe kishte këmbëngulur që, për qeverinë greke, do të ishte i kënaqshëm vetëm kthimi i *status quo*-së dhe asgjë tjetër. Pra, pala shqiptare kishte bërë përpjekje që t'u provonte grekëve se masat e saj për shtetëzimin e shkollave nuk drejtoheshin kundër arsimimit në gjuhën greke të popullsisë minoritare, por qeveria greke këmbëngulte në kërkesat e saj maksimaliste, duke pasur si qëllim që t'i nxirrte jashtë kontrollit të shtetit shqiptar shkollat minoritare. Kështu ishte e vështirë arritja e një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë midis dy palëve.

Weld-Forester pohonte se tashmë të dy palët po prisnin që Lidhja e Kombeve të bënte një prononcim lidhur me peticionin që i ishte dërguar Sekretarit të Përgjithshëm nga disa pjesëtarë të minoritetit grek në Shqipëri dhe secila priste një përgjigje të favorshme. Gjithashtu, ai informonte Londrën se, ndërkohë, asnjëra palë nuk po tregohej e përmbajtur. Incidentet po shumëfishoheshin dhe mund të përkeqësonin marrëdhëniet greko-shqiptare në të ardhmen.

Përfaqësuesi britanik informonte se qeveria shqiptare kishte transferuar disa mësues grekë nga Epiri i Veriut në Elbasan dhe në Lezhë, sepse ata ishin përgjegjës për ndalimin e fëmijëve që të shkonin në shkollë. Bojkotimi i shkollave po vijonte. Incidentin e tre aeroplanëve ushtarakë grekë të cilët, sipas ministrit të Jashtëm shqiptar, kishin fluturuar nga Janina në brendësi të territorit shqiptar për tri ditë rresht, menjëherë pas fillimit të grevës së fëmijëve të shkollave, Diamantopulosi e kishte mohuar, duke e cilësuar një ekzagjerim. Ai kishte pranuar se, ndoshta, vetëm një aeroplan që fluturonte në lartësi të mëdha mund të kishte kaluar kufirin pa dashje. Këtë shpjegim ai ia kishte dhënë edhe ministrit të Jashtëm shqiptar, i cili nuk kishte mbetur i kënaqur. Përfaqësuesi britanik i tha Diamantopulosit se ky kalim i pavullnetshëm i kufirit që përkonte me grevën shkollore, nuk mund të vlerësohej si i frytshëm në marrëdhëniet greko-shqiptare.¹⁹

¹⁹ *Po aty*, FO 371/18339. I Ngarkuari me Punë i Britanisë së Madhe në Durrës, Weld-Forester, për Sër John Simon, 17 tetor 1934.

Sipas diplomatit britanik, Weld-Forester, një incident tjetër që ndikonte negativisht për marrëdhëniet greko-shqiptare, ishte thirrja e një qytetari shqiptar, që punonte në konsullatën greke të Gjirokastrës për të kryer shërbimin ushtarak, i cili më pas ishte arrestuar. Xhaferr Vila e kishte cilësuar arrestimin si një gabim burokratik të autoriteteve ushtarake të cilat kishin pandehur se i kishin dërguar më parë thirrjen këtij subjekti për shërbimin ushtarak dhe ai nuk u ishte përgjigjur. Por, Vila i kishte thënë përfaqësuesit britanik se ai nuk do t'i kërkonte falje konsullit të Gjirokastrës për këtë gabim, për arsye se ai më parë ishte sjellë në një mënyrë jokorrekte. Madje, në qoftë se konsulli nuk do të hiqte dorë nga veprimet e tij të papranueshme, pala shqiptare do të kërkonte edhe suprimimin e konsullatës së Gjirokastrës.

Pritej që marrëdhëniet të përkeqësoheshin edhe më tej, pasi shtypi grek po zhvillonte një propagandë violente kundër qeverisë shqiptare për çështjen e shkollave. Diamantopulos i tha Weld-Foresterit se, edhe sikur qeveria e tij t'i sugjeronte një takim me Mbretin Zog, ky do t'i shkruante se ai do të ishte i padobishëm për arsye se Mbreti vetëm do të premtojte që do të ndihmonte për tejkalimin e vështirësive dhe nuk do të bënte asgjë për ta zgjidhur situatën e krijuar.²⁰

Ndërkohë, edhe qeveria shqiptare, duke dashur që t'u kundërpërgjigjej grekëve, po zhvillonte një propagandë lidhur me minoritetin shqiptar në Çamëri. Ministria e Jashtme e Shqipërisë i kishte dërguar një notë palës greke në të cilën denoncohej takimi i zhvilluar në Prevezë midis shefit të shtabit të divizionit të Prevezës, komandantit të xhandarmërisë së provincës së Çamërisë, drejtorit të Bankës Kombëtare dhe prefektit të Prevezës, ku ishte diskutuar sigurimi i një huaje për shumë të krishterë, me qëllim që ata të blinin me çmime shumë të ulëta pronat e shqiptarëve myslimanë dhe, kështu, t'i shtynin ata që të emigronin nga Çamëria. Xhaferr Vila i dha përfaqësuesit britanik edhe kopjen e një letre që i ishte dërguar atij nga konsulli shqiptar në Janinë, e cila fliste mbi përpjekjet e qeverisë greke për të arritur një marrëveshje me qeverinë turke lidhur me emigrimin e çamëve në Turqi.²¹

Konsulli shqiptar i Janinës informonte se një komision i çamëve, i përbërë nga myftiu i Paramithisë, Tefik Qemali nga fshati Karbunarë dhe Mehmed Hysein nga fshati Mazrek, i kishin thënë atij se qeveria greke po

²⁰ *Po aty.*

²¹ *Po aty.*

bënte propagandë në Çamëri për emigrimin e shqiptarëve në Turqi dhe kishte projektuar të dërgonte një komision në Turqi për të parë situatën e rajonit ku do të vendoseshin shqiptarët. Natyrisht, ky komision do të përbëhej nga njerëz që ishin shitur tek grekët. Gjithashtu, konsulli informonte se disa patriotë çamë i kishin dërguar një letër me 120-130 nënshkrime presidentit turk, të cilit i kërkonin të mos pranonte vendosjen e emigrantëve çamë në Turqi pasi kështu do të shkatërrohej Çamëria.²²

Weld-Forester arrinte në përfundimin se, po të lejoheshin marrëdhëniet midis qeverive greke e shqiptare të ecnin në këtë rrugë, ata mund të arrinin në një shkallë të lartë tensioni. Prandaj, në se kjo gjë ishte e dëshirueshme të shmangej, ai sugjeronte një ndërhyrje miqësore të përfaqësive britanike në të dy vendet që të ndihmonin qeveritë greke e shqiptare të gjenin rrugën për të tejkaluar situatën e krijuar.²³

Meqë çështja e shkollave greke po merrte karakter serioz, qeveria shqiptare u përpoq të sigurote përkrahjen ndërkombëtare. Dërgata shqiptare në Lidhjen e Kombeve mori një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të cilit i kërkoi një hetim mbi gjendjen e minoritetit grekofon në Shqipëri dhe të pakicës shqiptare në Greqi. Ajo e informoi Sekretarin e Lidhjes së Kombeve edhe për aktivitetin e konsujve grekë në Shqipëri dhe për shkeljet e kufirit shqiptar nga aeroplanët grekë²⁴. Përfaqësuesi shqiptar në Lidhjen e Kombeve, Lec Kurti i dorëzoi Sekretarit të Përgjithshëm notën e qeverisë shqiptare për çështjen e shkollave greke dhe i foli atij gjatë për gjendjen e minoritetit grekofon në Shqipëri, duke evidentuar dallimet që ekzistonin në trajtimin midis pakicës shqiptare në Greqi dhe asaj grekofone në Shqipëri²⁵.

Ministria e Jashtme e Shqipërisë sqaronte Sekretarin e LK se numri i shkollave greke, jo vetëm që ishte rritur, por ishte përmirësuar edhe funksionimi i tyre. Ajo pranonte se autoritetet lokale kishin marrë disa

²² TNA, FO 371/18339. Përkthim në anglisht i letrës së konsullit shqiptar të Janinës dërguar ministrit të Jashtëm të Shqipërisë, Janinë, 10 tetor 1934.

²³ Po aty, FO 371/18339. I Ngarkuari me Punë i Britanisë së Madhe në Durrës, Weld-Forester, për Sër John Simon, 17 tetor 1934.

²⁴ AMPJ, V. 1934, D. 255, fl. 163. Dërgata shqiptare në Gjenevë drejtuar MPJ, 9 tetor 1934.

²⁵ Po aty, V. 1934, D. 255/1, fl. 132. Lec Kurti, i Dërguari i Përhershëm i Shqipërisë në Gjenevë drejtuar MPJ, 9 tetor 1934.

masa ndaj 10 personave të cilët, për qëllime politike, kishin dashur të turbullonin shpirtin dhe situatën e qetë të popullsisë minoritare²⁶.

Por, argumentet shqiptare që i referoheshin reciprocitetit, i cili dukshëm fliste në favor të tyre, nuk peshonin shumë në Gjenevë. Lec Kurti informonte se Komiteti i të Tretëve, megjithëse kishte treguar simpati për pretendimet e Shqipërisë, kishte pohuar paraprakisht se nuk mund t'i shmangej të drejtës që kishin pakicat për të pasur shkollat e tyre në gjuhën e vet. Komiteti, duke parë se grekët vetëm kishin persekutuar pakicën shqiptare në Greqi, kishte shfaqur simpati për Shqipërinë por, si një ent juridik, ishte i detyruar të kërkonte prej saj zbatimin e Traktatit, konkretisht të lejohej gjuha greke si gjuha e parë e mësimi²⁷. Kjo do të thoshte që mësimi në të gjitha lëndët të zhvillohej në greqisht. Prandaj ai sugjeronte që qeveria shqiptare të bënte lëshim në këtë pikë pasi, në rast të kundërt, problemi do të shqyrtohej nga Këshilli i LK, i cili do të kërkonte po ato gjëra që kërkoheshin tani prej Komitetit. Kështu që Shqipërisë, pohonte ai, - nuk i mbetet gjë tjetër veçse t'i kërkojë Lidhjes së Kombeve me shkrim zbatimin e reciprocitetit, gjë të cilën e kishte këshilluar miqësisht dhe Drejtori i Pakicave në LK, i cili kishte kërkuar që të mos përmendej emri i tij. Komiteti i të Tretëve e kishte porositur përfaqësuesin shqiptar, "jo me bindje, por sa me la ndërgjegjen e tij", që autoritetet shqiptare të sillleshin butësisht me popullsinë grekofone²⁸.

Disa ditë më vonë, ministri i Jashtëm Xh. Vila i dërgoi një notë tjetër Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Avenolit, në të cilën nënvizonte se, prej shumë kohësh, në Athinë po zhvillohej një aktivitet i madh kundër qeverisë shqiptare e cila ishte akuzuar se po shtypte të drejtat e minoritetit në Shqipëri. Por, situata në realitet, ishte krejt e ndryshme dhe marrëdhëniet midis pakicës e shumicës ishin zhvilluar gjithmonë mbi një bazë besimi të përbashkët. Ai shtonte se udhëheqësit shqiptarë, në asnjë rast, nuk e kishin konsideruar minoritetin grek si të huaj por, përkundrazi, ai kishte përfituar nga të gjitha të drejtat, si një element konstruktiv i shtetit shqiptar. Vila, informonte se, popullsia grekofone gëzonte të drejtat politike, duke pasur edhe deputetë në Parlamentin Shqiptar, elementët grekofonë ishin të mirëpritur në të gjithë administratën e

²⁶ *Po aty*, fl. 9-10. Ministri i Jashtëm i Shqipërisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Tiranë, 15 tetor 1934.

²⁷ *Po aty*, fl. 51. Lec Kurti drejtuar MPJ, 19 tetor 1934.

²⁸ *Po aty*.

vendit; në ushtri, në xhandarmëri e në të gjitha degët e administratës civile. Minoriteti mësonte rregullisht greqishten në shkollat e licensuara nga Ministria e Arsimit, që harxhonte çdo vit për mbajtjen e këtyre shkollave, 160.000 fr. ar. Kjo ishte një shumë mjaft e madhe në krahasim me buxhetin e saj. Popullsia grekofone gëzonte lirinë e plotë të kultit dhe ritet në kisha kryheshin në gjuhën greke, nxënësit merrnin edukimin fetar në greqisht nga priftërinj të caktuar nga funksionarë të lartë fetarë. Vila denonconte rolin negativ që po luanin disa “mbrojtës vullnetarë”, duke mbjellë mosmarrëveshje midis dy elementëve, të cilët jetonin në qetësi. Ai pranonte se, policia e rajonit, duke konstatuar se rreth 10 persona tentonin të ndalonin nxënësit të frekuentonin shkollat, i kishte dënuar me ndalim të përkohshëm në shtëpi për t’i penguar në këtë aktivitet të dëmshëm²⁹.

Të njëjtat argumente u parashtuan në një peticion që iu dërgua Lidhjes së Kombeve nga një miting i madh i popullit të Gjirokastrës, i cili protestoi kundër akuzave që ishin bërë në mbledhjen e Athinës³⁰.

Qeveria shqiptare u përpoq ta kundërgodiste propagandën greke për problemin e minoritetit edhe në shtypin ndërkombëtar. Mirëpo mundësitë e saj ishin të kufizuara. Dërgata shqiptare në Lidhjen e Kombeve informonte se, ishte shumë e vështirë të ndërmerrej një kundërofensivë në shtypin e Gjenevës. Drejtori i “Journal de Geneve” ishte kryetar i Ligës Greko-Gjenevese, fletoret e tjera ishin filohelenike, ndërsa fletorja “Journal des Nations” ishte në shërbim të Antantës së Vogël³¹.

Qeveria shqiptare udhëzoi përfaqësitë diplomatike se si duhej të mbronin politikën e saj për shtetëzimin e shkollave. Në një qarkore³² që u adresoi atyre, ajo vinte në dukje se edhe pas shtetëzimit të shkollave, kishte treguar një kujdes të veçantë për mësimin e greqishtes në të gjitha shkollat e katundeve grekofone. Pranohej se në vitin e parë shkollor nuk kishte qenë e mundur çelja e shkollave kudo që ishin të nevojshme, për arsye të mungesës së kohës për organizimin e tyre dhe, sidomos, nga mungesa e trupit mësimor të besuar e të aftë. Por, qeveria kishte në programin e saj objektivin që mësimin e gjuhës greke, jo vetëm ta zgjeronte në të gjitha fshatrat grekofonë, por edhe ta përmirësonte, duke

²⁹ *Po aty*, fl. 98-100. Xh. Vila për J. Avenol, Tiranë, 24 tetor 1934.

³⁰ *Po aty*, fl. 113-114. Peticion i popullsisë së Gjirokastrës dërguar Lidhjes së Kombeve, 23 tetor 1934.

³¹ *AMPJ*, V. 1934, D. 144, fl. 42. Lec Kurti drejtuar MPJ, Gjenevë, 24 tetor 1934.

³² *Po aty*, fl. 45-46. MPJ drejtuar përfaqësive shqiptare, 27 tetor 1934.

rritur cilësinë e mësuesve dhe atë të programit mësimor. Qarkorja vinte në dukje se lëvizja antishqiptare që kishte ngjallur shtypi grek dhe elementët turbullues, me anë të mitingjeve në Greqi, nuk ishte shkaktuar nga shqetësimi se gjuha greke ishte në rrezik dhe se elementi grekofon po shqiptarizohej por, vetëm e vetëm, se ata po shihnin qartë se privilegjet e tyre shkollore e fetare, që kishin trashëguar nga koha e Turqisë, të cilat i përdornin si vegël politike, nuk lejoheshin më në Shqipëri. Në këtë masë të qeverisë shqiptare, ata panë se ishte rrezikuar qëllimi i tyre i vërtetë: shpresat imperialiste që kishin kundrejt Shqipërisë. Qeveria justifikohej se ndryshimi i numrit të shkollave të komunitetit grekofon nuk ishte shqetësues, sepse, më parë në prefekturën e Gjirokastrës, kishte pasur 45-48 shkolla me 70-75 mësues, ndërsa tani numri i këtyre shkollave përkohësisht ishte 38 dhe ato kishin 70 mësues. Qarkorja vinte në dukje se, shqetësimi i elementëve panhelenikë kishte në themel ndryshimin e situatës së brendshme të shkollave. Më parë, shkollat e tyre komunale ishin një fole e propagandës helenike, pa rregull e pa kontroll, shtet brenda shtetit, në të cilat mësimi kryesor ishte greqishtja dhe shqipja kishte mbetur tërësisht në dorë të dytë. Ndërsa tani greqishtja dhe shqipja po mësoheshin në mënyrë të barabartë dhe shteti kishte në dorë kontrollin e nevojshëm që, me anë të shkollave, të formonte bashkimin kombëtar në të gjithë popullsinë shqiptare.

Përsa u përkiste detyrimeve që kishte marrë Shqipëria në Lidhjen e Kombeve, ku grekët përpiqeshin të bazonin pretendimet e tyre për privilegjet shkollore, qeveria shqiptare i referohej artikullit 5 të kësaj deklarate, i cili theksonte se të drejtat e mësimit, si dhe çdo e drejtë tjetër, do të ishin të barabarta me ato që gëzonte shumica e shqiptarëve. Kështu, meqë shteti shqiptar kishte shtetëzuar të gjitha shkollat private edhe shkollat komunale greke nuk mund të vazhdonin të ekzistonin, sepse do të krijonin një privilegj jashtë statutit i cili, jo vetëm do të ishte i barabartë me kapitulationet, por do të quhej një autonomi lokale për elementin grekofon, gjë që nuk pajtohej me njësinë dhe jetesën e shtetit shqiptar.

Qeveria shqiptare pohonte se e kishte demonstruar respektimin e të drejtave të pakicës, jo vetëm në çështjen e shkollave, por edhe në të gjitha drejtimitet e tjera, duke treguar “në gjithë kuptimin e fjalës, një shpirtgjerësi aq të madhe, saqë nuk e kishte bërë deri në këtë kohë asnjë shtet ballkanik”. Grekofonët ishin pranuar në radhën e nëpunësve më të lartë të shtetit, e oficerëve, policisë, xhandarmërisë, në një proporcion që

nuk i përshtatej aspak numrit të tyre në raport me popullsinë e përgjithshme të Shqipërisë. “Asnjë shtrëngim përse i përket përdorimit të gjuhës së tyre, gëzimit të pasurisë së tyre, sigurimit të jetës dhe nderit të tyre nuk u është bërë kurrë. Ndërsa gjithë këto të drejta që u përkasin pakicave janë shkelur në mënyrë të padurueshme nga qeveria greke ndaj pakicës shqiptare në Çamëri”. Me gjithë këto, qeveria shqiptare i ishte përgjigjur Seksionit të Pakicave pranë LK, duke i dhënë të gjitha hollësitë, duke i dërguar listat e shkollave, të mësuesve dhe nxënësve dhe gjithë programin e instruksionet (edhe kur këto kishin qenë sekrete) që Ministria e Arsimit i kishte dhënë herë pas here inspektorisë së saj në Gjirokastrë.

Përfaqësitë shqiptare do t’u deklaronin diplomatëve dhe agjencive të huaja se “Shtypi dhe populli shqiptar, me një gjakftohtësi të jashtëzakonshme, ka duruar çdo poshtërim që ka ardhur nga ana e grekëve, sepse dëshira jonë për një marrëveshje miqësore dhe për mënjanimin e çdo shkakut turbullues të kësaj miqësie është një parim kryesor i politikës sonë. Vetëm duhet që grekët të binden plotësisht se privilegjet që kanë gëzuar në kohën e Turqisë, me të cilat kanë shkatërruar gjendjen e saj, janë të vdekura për jetë”.³³ Kjo do të ishte vija që përfaqësitë shqiptare do të pozonin problemin në arenën ndërkombëtare.

Përfaqësuesi i Shqipërisë në Gjenevë, Lec Kurti i propozoi Ministrisë së Jashtme që, për të mos humbur simpatinë e Lidhjes së Kombeve, përgjigjja më elegante për këtë çështje do të ishte kjo: Shqipëria, siç e ka deklaruar dhe provuar gjithmonë me fakte, edhe në këtë rast, nderonte të drejtat e pakicave kombëtare sipas angazhimeve të marra. Qysh prej krijimit të shtetit shqiptar, grekofonët, megjithëse ishin në një numër të kufizuar dhe shumica e tyre ishin bujq, kishin gëzuar të gjitha të drejtat që parashikonte Traktati i Pakicave. Në kisha meshonin greqisht priftërinj grekofonë. Reforma shkollore që kishte bërë qeveria shqiptare synonte perfeksionimin e arsimit fillor të gjithë shtetit, në të mirën e përgjithshme, duke spastruar personelin e paaftë arsimor. Për këtë arsye, u hoqën shumë mësues të paaftë, gjë që shkaktoi mbylljen e shumë shkollave në vise të banuara nga shqiptarët, duke menduar se ishte më mirë të kishte më pak shkolla por të dobishme se sa më shumë e të

³³ *Po aty.*

cekëta³⁴. Mjerisht kjo masë e përgjithshme nuk mund të mos prekte edhe një pjesë të mësuesve grekofonë, të cilët linin shumë për të dëshiruar nga pikëpamja e aftësive pedagogjike. Lec Kurti, sugjeronte që të evitohej diskutimi i çështjes nga Këshilli i LK, sepse kështu do të fitohej një superioritet në bisedimet që mund të hapeshin midis Shqipërisë e Greqisë pasi, në këtë mënyrë, qeveria shqiptare do të afirmonte të drejtën e saj për të formuar trupin mësimor të shkollave greke.

Ministri i Jashtëm informoi Mbretin Zog se Lec Kurti kishte propozuar që qeveria shqiptare t'i dorëzonte Lidhjes së Kombeve një letër për çeljen e shkollave në Çamëri. Mirëpo, meqë qeveria greke po tregohej e gatshme të çelte shkollat, ai e quante të padobishme dërgimin e një letre të tillë. Madje, ai kishte dyshime nëse Këshilli i LK do t'i kërkonte qeverisë greke të mbante zotimet për çeljen e shkollave në Çamëri. Edhe Mehdi Frashëri nuk shihte ndonjë dobi për dërgimin e kësaj letre dhe mendonte që, pikësëpari, kompromisi duhej arritur në Tiranë dhe pastaj t'i bëhej një deklaratë Sekretarisë së Përgjithshme të LK. Edhe ai kishte frikë se Komiteti i të Tretëve do të diskutonte edhe peticionin e katolikëve³⁵. Marrja e këtij vendimi ishte një çështje urgjente sepse Komiteti i të Tretëve mund të mblidhej javën e parë të nëntorit. Prandaj, ministri i Jashtëm i kërkonte A. Zogut udhëzime të shpejta.

Sidoqoftë, nëse çështja e shkollave greke do të shtrohej për diskutim në Këshillin e LK, Ministria e Jashtëm i kërkoi ministrit në Gjenevë, Lec Kurti që më parë Lidhjes së Kombeve t'i paraqitej një peticion lidhur me mësimin shqip në shkollat e Çamërisë³⁶. Edhe ky e mbështeste dërgimin e peticionit. Ai kishte biseduar me Drejtorin e Seksionit të Pakicave në LK, i cili i kishte sugjeruar miqësisht se peticioni të dërgohej në një formë elegante, pasi në këtë mënyrë do të vonohej marrja e një vendimi të prerë nga Komiteti i të Tretëve, i cili nuk tërhiqej nga qëndrimi i tij për ta shqyrtuar çështjen vetëm nga pikëpamja juridike. Ai premtoi se edhe peticionin e qeverisë shqiptare do të përpiquej, sa të ishte e mundur, për t'ia kaluar për shqyrtim po atij Komiteti që po shqyrtonte ankesat e grekofonëve³⁷.

³⁴ *Po aty*, V. 1934, D. 255/1. Lec Kurti drejtuar MPJ, Gjenevë, 1 nëntor 1934.

³⁵ *Po aty*, fl. 189-191. Legata shqiptare Athinë drejtuar MPJ, 29 tetor 1934.

³⁶ *Po aty*, fl. 120. MPJ drejtuar ministrit Lec Kurti në Gjenevë, 25 tetor 1934.

³⁷ *Po aty*, fl. 163. Lec Kurti drejtuar MPJ, 27 tetor 1934.

Për ta bërë më të freskët tablonë e masave të reja që kishte marrë qeveria shqiptare në vijim të zbatimit të reformës dhe tejkalimit të vështirësive që ishin krijuar në fillim të zbatimit të saj, Ministria e Arsimit në fund të tetorit informoi Ministrinë e Punëve të Jashtme se në prefekturën e Gjirokastrës kishte gjithsej 136 shkolla fillore me 221 mësues. Prej tyre, 93 mësues ishin për shkollat grekofone. Për shkollat fillore shqipe të kësaj prefekturë shteti harxhonte 260 000 fr. ari në vit, ndërsa për shkollat fillore grekofone 172.800 fr. ari në vit. Ndërsa në shkollat fillore e të mesme kishte 47 mësues e profesorë grekofonë³⁸. Efektiviteti dhe serioziteti i këtyre masave dilte në pah, nëse krahasohej me tablonë e gjendjes së popullsisë. Popullsia e qarkut të Gjirokastrës ishte 144 819 banorë, numri i popullsisë grekofone të këtij qarku ishte 37 271 vetë e shpërndarë si më poshtë: Dropulli (qendra e Gjirokastrës) 21 005, Saranda 2 138, Delvina 9 589, Konispoli 4 145 dhe Përmeti 394. Por, në katundet grekofone, që kapnin numrin 96, kishte edhe myslimanë e ortodoksë shqiptarë. Në Ministrinë e Brendshme kishte 9 nëpunës grekofonë si kryetarë e sekretarë komunash. Në Parlamentin shqiptar kishte dy deputetë grekofonë³⁹.

Paralelisht me problemin e shkollave grekofone, qeveria shqiptare po ndeshëj edhe me ankesat e klerit katolik për mbylljen e shkollave katolike. Qeveria krijoi një komision për shqyrtimin e ankesave të katolikëve shqiptarë dhe të grekofonëve, i cili dha këto rekomandime:⁴⁰

-Katolikët ishin, pa asnjë dyshim, të racës shqiptare dhe, kështu, nuk mund të konsideroheshin minoritet. Por, fatkeqësisht, deklarata e qeverisë shqiptare në Lidhjen e Kombeve më 2 tetor 1921 e kishte pranuar fenë krah për krah me ndryshimin e gjuhës e të racës. Prandaj, ndonëse nga pikëpamja kombëtare në politikën e brendshme nuk mund të bëhej fjalë për minoritet katolik, angazhimi juridik i deklaratës ekzistonte. Për këtë arsye qeveria mund të refuzonte tri çështjet e ankesës së klerit katolik: 1. Kodi civil shqiptar e pranonte shkurorezimin për popullsinë jokatolike. Ai që e quante veten katolik ishte i lirë që të mos shkurorezohej. Por nëse një katolik nuk kishte këtë bindje dhe i drejtohej gjyqit për shkurorezim, atëherë qeveria shqiptare, si qeveri laike, pa

³⁸ *Po aty*, fl. 123. Ministria e Arsimit drejtuar MPJ, 25 tetor 1934.

³⁹ *Po aty*, fl. 150. MPB drejtuar MPJ, 27 tetor 1934.

⁴⁰ *AMPJ*, V. 1934, D. 144, fl. 51-54. Shpjegim mbi ankesat e klerit katolik për mbylljen e shkollave etj., 2 nëntor 1934.

ngjyrë fetare, nuk mund të dhunojë ndërgjegjen e qytetarit të lirë katolik. Përndryshe, Kodi Civil Shqiptar do të tradhtonte parimet e laicitetit dhe të lirisë së ndërgjegjes. Ndërsa martesë civile e pranuar me Kodin Civil nuk e ndalonte bekimin e kishës; 2. Mësimi fetar ishte i lirë për të gjitha komunitetet fetare, ndërsa mësimin civil e laik e kishte marrë në dorë shteti, njësoj për të gjitha besimet; 3. Kleri katolik ishte ankuar se ishte ndaluar prifti i Elbasanit që të predikonte në kishën unite. Komisioni shpjegonte se, në bazë të Statutit të Mbretërisë dhe në mbështetje të Deklaratës së vitit 1921, çdo shqiptar ishte i lirë, jo vetëm të ushtronte lirinë e ndërgjegjes e të kultit që ka pasur, por të ndërronte edhe fenë. Prandaj teorikisht, një ose më shumë ortodoksë, që pranonin lirisht dhe hirisht të njihnin autoritetin e Selisë së Shenjtë, domethënë të quheshin unitë me rite ortodokse, kishin të drejtë të kishin kler e kishë të posaçme. Por, kjo liri nuk lejonte propagandën e huaj me të holla, për qëllime proselitismi, e cila kishte si prapamendim një qëllim politik⁴¹.

Lidhur me kërkesat e grekofonëve, Komisioni u jepte përgjigje të gjitha çështjeve në këtë mënyrë:⁴²

- Grekofonët e kishin akuzuar qeverinë shqiptare se në shkollat e tyre mësimi po zhvillohej në gjuhën shqipe dhe se greqishtja mësohej vetëm si gjuhë. Në fakt, sipas Deklaratës së vitit 1921, mësimi duhej të bëhej në gjuhën e minoritetit dhe shqipja do t'u mësohej nxënësve në mënyrë serioze, bashkë me historinë e gjeografisë e Shqipërisë. Ndërsa të gjitha lëndët e tjera do të zhvilloheshin në greqisht. Komisioni e konsideronte të drejtë këtë kërkesë të tyre;

- Mësuesit e greqishtes duhej të kishin zotësi të provuar, në bazë të titujve shkollorë: normale, lice ose të paktën gjimnaz 5-vjeçar greqisht. Për këtë arsye, edhe këtë kërkesë Komisioni e konsideronte të drejtë;

- Ankesën e tyre se minoritetit i ishte suprimuar e drejta për të krijuar shkolla në gjuhën e tyre me shpenzimet e veta, Komisioni e konsideronte të padrejtë, sepse krijimi i shkollave të tilla ishte i kushtëzuar me barazinë për të gjitha komunitetet. Meqë arsimit civil ishte suprimuar për të gjitha besimet fetare edhe komuniteti grekofon nuk kishte të drejtë të veçantë;

- Ankesa e grekofonëve për persekutime fetare nga qeveria, konsiderohej e paargumentuar, pasi vetë ata nuk kishin mundur të

⁴¹ *Po aty.*

⁴² *Po aty.*

paraqisnin fakte konkrete. Prandaj mendohej që kësaj çështjeje të mos i jepej përgjigje. Megjithëkëtë, Komisioni konstatonte se disa nga mësuesit kishin ndaluar nxënësit të respektonin ikonat që ndodheshin në shkolla, gjë e cila duhej të ndreqej menjëherë;

- Komisioni konstatonte se në vitin 1925-1926 minoriteti grekë kishte pasur 78 shkolla me 113 mësues, ndërsa në vitin 1932-1933 kishte pasur 10 shkolla me 11 mësues. Këtë gjendje ai e cilësonte “një pakujdesi të palejueshme të Ministrisë së Arsimit”, e cila e kishte korrigjuar atë dhe tashmë numri i shkollave greke kishte arritur në 38. Edhe pse nuk ishte arritur shifra e vitit 1925-1926, shkaku ishte vetëm tek vështirësitë buxhetore dhe nga disproporcioni i shkollave greke me shkollat e tjera shqiptare të asaj kategorie, i cili ishte në favor të shkollave greke.

Siç shihet, analizat dhe rekomandimet e Komisionit ishin të sakta, të drejta dhe me një frymë vetëkritike. Ato provonin se qeveria shqiptare, më në fund, po i jepte një zgjidhje të drejtë dhe po demonstronte vullnet të sinqertë për ta rregulluar një herë e mirë çështjen e shkollave minoritare. Rekomandimet e komisionit kishin rëndësi sepse u jepnin zgjidhje disa problemeve themelore që ishin vërejtur në funksionimin e shkollave minoritare. E para, veprimtaria arsimore disiplinohet në drejtim të kuadrit mësimor, duke siguruar nivelin e duhur profesional të tij dhe përgjegjshmërinë ndaj autoriteteve kompetente; E dyta, sigurohet financimi i qëndrueshëm i shkollave nga buxheti i shtetit shqiptar; së treti shmangej propaganda politike nacionaliste e qeverisë greke dhe e qarqeve vorio-epirote në shkollat greke, e cila deri në këtë kohë ishte zhvilluar nëpërmjet mësuesve privatë të paguar nga këto subjekte. Në këtë mënyrë, do të realizohej bashkëjetesa e qetë e minoritetit me institucionet shqiptare, pa u cenuar aspak identiteti dhe ndërgjegjja e tij kombëtare. E vetmja që do të prekej në këtë rast do të ishte veprimtaria nacionaliste e sillogjeve vorio-epirote dhe ndërhyrja e qeverisë greke, e cila e kishte përdorur minoritetin si një bastion të betejës së saj për fuqizimin e helenizmit në Shqipërinë e Jugut.

Pas konstatimeve me vlerë të këtij komisioni, në fillim të nëntorit, ministri i Jashtëm i Shqipërisë i parashtrori Sekretarit të Përgjithshëm shpjegimet suplementare lidhur me minoritetin grek në Shqipëri⁴³. Ai shpjegonte se, në vijim të reformave konstitucionale për shtetëzimin e

⁴³ *Po aty*, fl. 181-185. Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Tiranë, 3 nëntor 1934.

shkollave private, ndryshoi edhe statusi i mëparshëm i shkollave greke. Shteti mori përsipër mbajtjen e tyre por në fillim ai nuk pati mundësi, veçse të siguronte pjesërisht funksionimin e tyre dhe në vitin vijues shkollor e përmirësoi ndjeshëm gjendjen e shkollave greke. Shqipëria kishte bërë sakrifica materiale që i tejkalonin shumë detyrimet e qeverisë shqiptare për mbajtjen e këtyre shkollave. Tashmë, personeli i shkollave u kompletua dhe kishte cilësitë e duhura, numri i shkollave minoritare ishte proporcionalisht më i madh se ai i shkollave shqiptare. Në minoritet kishte 1 shkollë për 829 banorë, ndërsa në popullsinë shqiptare të qarkut të Gjirokastrës kishte 1 shkollë për 1500 banorë. Për mbajtjen e të gjitha shkollave fillore të prefekturës së Gjirokastrës ishte lëvruar një shumë prej 260.000 fr. ari, prej të cilave 172.800 ishin destinuar për shkollat minoritare. Të gjitha lëndët në këto shkolla do të jepeshin në greqisht, në përputhje me nenin 6 të Deklaratës së vitit 1921 dhe, gjithashtu, gjuha shqipe do të ishte e detyruar.

Pala shqiptare pretendonte se, vërtet neni 5 i Deklaratës së vitit 1921 përcaktonte të drejtat e minoriteteve për të mbajtur e drejtuar shkolla, por, kjo e drejtë më parë u kishte takuar të gjithë qytetarëve shqiptarë, ndërsa tashmë u ishte suprimuar. Popullsia minoritare nuk mund të gëzonte më shumë të drejta se ajo në shumicë. Qeveria shqiptare shprehte bindjen se ky parim barazie i përcaktuar në nenin 5 të Deklaratës, ishte në përputhje me frymën e Traktateve të Minoriteteve e nuk mund të vihej në diskutim. Kjo tezë ishte diskutuar disa herë, veçanërisht në deklaratat që i kishte bërë përfaqësuesit shqiptar, Drejtori i Seksionit të Minoriteteve, Colban, në gusht të vitit 1923, me rastin e diskutimit të ligjit shqiptar mbi komunitetet fetare e mbi statutin e shkollave minoritare.

Ministria e Jashtme e Shqipërisë nënvizonte se edhe përfaqësuesit grekë kishin pasur rastin të pohonin drejtësinë e së njëjtës tezë në Lidhjen e Kombeve. Kështu për shembull, në seancën e IV të Komisionit VI të Asamblesë, më 16 shtator 1925, Dendramis kishte deklaruar se “nëse do t’i akordoheshin privilegje minoritetit të një shteti, do krijohesh një pabarazi ndërmjet këtij minoriteti dhe shumicës, sepse kjo e fundit do të shtypej nga minoriteti dhe, atëherë, do të ishte problemi i shumicës që do të shtrohej para Lidhjes së Kombeve”.

Ministria e Jashtme deklaronte se në Shqipëri minoritetet gëzonin të gjitha të drejtat e njohura qytetare, ato kishin shkolla në gjuhën e tyre, ishin pranuar pa asnjë dallim në funksionet publike të shtetit, të bashkive

e të institucioneve qeveritare, kishin përfaqësuesit e vet në parlament dhe në këshillat komunale e të prefekturave.

Pasi jepte këto shpjegime, Ministria e Jashtme deklaronte se, megjithëse detyrimet e Greqisë ndaj Lidhjes së Kombeve për mbrojtjen e minoriteteve ishin identike “mbrojtja e minoritetit shqiptar atje ishte zero, sepse asnjë shkollë shqipe nuk funksiononte në Greqi, asnjë përfaqësues i minoritetit shqiptar nuk ishte në Parlamentin Grek, dhe as në bashkitë ku banonte ky minoritet. Kjo situatë është prezantuar më shumë se një herë në Lidhjen e Kombeve, qoftë nga përfaqësuesi i qeverisë shqiptare më 1928, qoftë edhe nëpërmjet peticioneve të shumta dërguar nga pjesëtarë të minoritetit shqiptar. Ne konstatojmë me keqardhje të madhe se këto reklamime kanë mbetur pa asnjë rezultat praktik dhe që një pabarazi evidente në zbatimin e obligimeve për mbrojtjen e minoriteteve, vazhdon të ekzistojë”⁴⁴.

Më 6 nëntor 1934, Ministria e Jashtme e Shqipërisë përgatiti një letër tjetër që do t'i adresohet Lidhjes së Kombeve ku njoftonte se qeveria shqiptare kishte marrë masa që artikulli 6 i Deklaratës së vitit 1921 të zbatohet plotësisht, domethënë në shkollat greke i gjithë mësimi do të bëhej në gjuhën greke. Ajo informonte se e vetmja gjë që nuk pranohej nga qeveria shqiptare ishte interpretimi i artikullit 5 që fliste për të drejtën e mbajtjes së shkollave private nga komunitetet e ndryshme në Shqipëri. Qeveria shqiptare qëndronte e patundur në vendimin e saj që mësuesit do t'i zgjidhte Ministria e Arsimit. Mirëpo këtë letër dhe dosjen që i adresohet Sekretarit të Përgjithshëm të LK, ajo ende nuk kishte vendosur t'ia dorëzonte Sekretarisë së LK⁴⁵.

Me anë të një qarkoreje, Ministria e Arsimit Publik komunikoi më 8 nëntor 1934 që mësimi fetar do të bëhej dy herë në javë: të dielën dhe në gjysmën e një dite tjetër pushimi të javës, të caktuar nga vetë fshati. Emrat e mësuesve të ngarkuar për mësimin fetar dhe ambienti i caktuar për këtë qëllim do t'i përcilleshin nga autoritetet klerikale Ministrisë së Arsimit për aprovim⁴⁶. Një javë më vonë, po kjo ministri shpalli se arsimit fetar në shkolla ishte hequr dhe ai mund të jepej vetëm jashtë shkollave e jashtë orarit shkollor. Ambienti i nevojshëm për këtë qëllim do të gjendej

⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁵ *AMPJ*, V. 1934, D. 255/1, fl.186. MPJ drejtuar Lec Kurtit, 6 nëntor 1934.

⁴⁶ *Po aty*, V. 1935, D. 297, fl. 310. Qarkore e Ministrisë së Arsimit Publik, 8 nëntor 1934.

nga drejtori i shkollës, në bashkëpunim me autoritetet administrative. Mësuesit e kësaj lënde do të miratoheshin nga Ministria e Arsimit, ndërsa drejtorët e shkollave do të inspektonin mësimin fetar për t'u siguruar që asnjë veprim nuk do të cenonte unitetin kombëtar, detyrë e cila do të ishte një nga parimet bazë të edukimit kombëtar. Duhesh gjithashtu të evitoheshin ngacmimet që mund të sillnin antagonizma midis elementëve të ndryshëm⁴⁷.

Në mesin e nëntorit, Mehdi Frashëri takoi Sekretarin e Përgjithshëm të LK, të cilit i shpjegoi “barazinë për të cilën bënte fjalë neni 6 i Deklaratës mbi të drejtat e pakicave”. Avenol iu përgjigj se çështja e “barazisë” është një çështje juridike dhe se ai ishte më shumë i shqetësuar nga agjitacioni i Greqisë, i cili kishte një rëndësi politike⁴⁸. Pra, Sekretari i Përgjithshëm e bëri të qartë se çështja kishte ngjyrë politike.

Mehdi Frashëri konstatonte se grekët, me anë të telegrameve, agjencive të lajmeve, me anë të shtypit evropian, me anë të mitingjeve të ekzagjeruara në të gjithë Greqinë, donin t'i jepnin një rëndësi të jashtëzakonshme dhe ta zgjeronin çështjen përtej problemit minoritar, për gjithë Epirin e Veriut. Ai i shkruante Ministrisë së Jashtme: “më tepër se sa çështja e shkollave, është rëndësia politike që po përpiqen me i dhënë grekët asaj, për të vënë në diskutim edhe një herë çështjen e Epirit, duke qenë se Greqia mbështetej në Lidhjen e Kombeve, ndërsa ne me Aleaten tonë (Italinë), jemi në marrëdhënie më të tharta”. Ai kërkonte leje që të parashtronte në Lidhjen e Kombeve çështjen e pakicave shqiptare në Greqi⁴⁹.

Në fund të nëntorit, Komiteti i të Treve vendosi që problemi i shkollave greke të paraqitej në Këshillin e Lidhjes së Kombeve⁵⁰. Megjithëse vendimi u mor unanimisht, delegacioni shqiptar në Gjenevë mendonte se peshën më të madhe e kishte pasur influenca e juristit anglez, i cili kishte ngulur këmbë veçanërisht për të drejtën e shkollave private⁵¹. Mehdi Frashëri e vlerësoi vendimin e Komitetit të Treve “relativisht në favor të Shqipërisë” dhe, meqë në Sekretarinë e Lidhjes së

⁴⁷ *Po aty*, fl. 311. Qarkore e Ministrisë së Arsimit Publik, 14 nëntor 1934.

⁴⁸ *AMPJ*, V. 1933, D. 493, fl. 63. Mehdi Frashëri drejtuar MPJ, Gjenevë, 16 nëntor 1934.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ *Po aty*, V. 1934, D. 255/1, fl. 254. Mehdi Frashëri drejtuar MPJ, 21 nëntor 1934.

⁵¹ *Po aty*, V. 1934, D. 144, fl. 108. Dërgata e Shqipërisë në Gjenevë drejtuar MPJ, 24 nëntor 1934.

Kombeve atij i kishin thënë se e drejta e emërimit të mësuesve nga ana e qeverisë shqiptare do të konfirmohej, mendoi se nuk duhej bërë alarm i madh. Veçanërisht duheshin mbajtur ujërat e qeta me diplomatët italianë. Atyre mund t'u përmendej vetëm aleanca shqiptaro-italiane dhe të pyeteshin se, në rast se territori shqiptar do të sulmohej nga bandat vorio-epirote, a do të konsiderohej ky veprim prej tyre si një sulm apo jo. M. Frashëri i konsideroi masat e sigurimit në kufirin greko-shqiptar të domosdoshme, por sugjeronte që atyre nuk u duhej dhënë një karakter mobilizimi. Gjithashtu, ai kërkonte që edhe shtypi shqiptar të mbronte të drejtat e Shqipërisë⁵².

Ministria e Jashtme tashmë filloi të mendonte që të bënte një kundërsulm ndaj Greqisë në mbledhjen e Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Ajo udhëzoi Mehdi Frashërin t'i dërgonte një letër Sekretarit të Përgjithshëm, në të cilën të thuhej se, në kundërshtim flagrant me traktatin për minoritetet, qeveria greke nuk kishte hapur asnjë shkollë në gjuhën shqipe në Çamëri. Në letër do të përmendej edhe mosnjohja e mosrespektimi i të drejtave civile, politike e kulturore të pakicës shqiptare nga qeveria greke dhe do të bëhej një krahasim me situatën e minoritetit grekofon në Shqipëri. Por, duhej gjetur mënyra se ku do të bazohej kërkesa për ta diskutuar edhe çështjen e minoritetit shqiptar në Greqi, në Statutin e Lidhjes së Kombeve ose në procedurën e zakonshme, sepse ishte frika që, duke ju referuar një artikulli të Paktit të Lidhjes së Kombeve, kjo kërkesë e Shqipërisë mund të rrëzohej, ashtu siç kishte ndodhur disa vjet më parë⁵³.

Përfaqësuesi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, Lec Kurti i dërgoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm mbi gjendjen e minoritetit shqiptar në Greqi.⁵⁴ Ai i parashtroi Avenolit shqetësimin se minoriteti shqiptar në Greqi po keqtrajtohej nga qeveria greke, e cila kishte shkelur tërësisht nenet 2,3,7,8,9, të Traktatit të Sevres dhe se ky minoritet nuk kishte gëzuar kurrë asnjë nga të drejtat që i njihte Traktati i Minoriteteve dhe konkretisht:

⁵² *Po aty*, V. 1933, D. 493, fl. 95. Mehdi Frashëri drejtuar MPJ, Gjenevë, 26 nëntor 1934.

⁵³ *Po aty*, fl. 77. Udhëzime të MPJ drejtuar Mehdi Frashërit e Lec Kurtit, 23 nëntor 1934.

⁵⁴ *AMPJ*, V. 1935, D. 77, fl. 259-261. Letër e delegatit të Përhershëm të Shqipërisë në LK Lec Kurti për Sekretarin e Përgjithshëm të LK, 29 nëntor 1934.

1 - Kishte një mungesë absolute të shkollave, si private ashtu dhe publike në gjuhën shqipe;

2 - Qeveria greke kishte marrë masa të rrepta për të ndaluar kërkimin dhe mbrojtjen e të drejtave;

3 - Edhe pse minoriteti shqiptar në Greqi kishte vepruar gjithmonë në respekt të ligjeve të shtetit helen, autoritetet greke nuk i kishin siguruar atij as të drejtat më elementare. Ai i kërkonte J. Avenolit që kjo çështje të trajtohej në përputhje me Traktatin e Minoriteteve që edhe minoriteti shqiptar të kishte të drejta të barabarta me të tjerët në Greqi⁵⁵.

Gjithashtu, ai njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm të LK se komitetet vorio-epirote po vazhdonin hapur regjistrimin e vullnetarëve, sidomos në Janinë dhe paralajmëroi se qeveria shqiptare do të detyrohej të merrte masa mbrojtëse, duke dërguar një forcë ushtarake në viset e Gjirokastrës⁵⁶.

Por, Sekretari i Përgjithshëm nuk e mori seriozisht parashtrësën e tij. Avenol dukej se ishte më shumë i preokupuar për shkollat e minoritetit grek dhe shprehu shqetësim për ankesat e grekëve, por Kurti i shpjegoi se situata nuk ishte ashtu siç e paraqisnin ata. Pastaj, përfaqësuesi shqiptar goditi një nga pikat e dobëta të politikës greke, e cila vërtetonte qëndrimin e Athinës kundër bashkëpunimit ballkanik. Ai i tha Avenolit se në mbledhjen e Aleancës Ballkanike në Ankara, Greqia kishte kundërshtuar rreptësisht një propozim për pranimin e Shqipërisë si anëtare e kësaj aleance. Ky qëndrim dëshmonte se Greqia kishte qëllime negative ndaj Shqipërisë dhe, duke vepruar në këtë mënyrë “po ndihmonte përpjekjet e një Fuqie të Madhe për të mbajtur të përçarë popujt e Ballkanit dhe, njëherazi, po shkaktonte kështu, me të gjitha arsyet, refuzimin e Jugosllavisë për të marrë një vendim të caktuar në marrëveshjen ballkanike”. Përfaqësuesi shqiptar i kërkoi Avenolit që të mos ua vinte veshin shpifjeve e intrigave greke⁵⁷.

Avenoli kërkoi që Drejtori i Pakicave, Rosting të bënte një vizitë në Shqipëri. Kurti e kundërshtoi me takt këtë kërkesë, duke pohuar se qeveria shqiptare ishte kurdoherë e gëzuar që të priste funksionarët e Lidhjes së Kombeve por, meqë grekët i kishin çuar punët deri në këtë

⁵⁵ *Po aty*, V. 1934, D. 144, fl. 256. Përfaqësuesi i Përhershëm i Shqipërisë në LK, Lec Kurti dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Gjenevë, 29 nëntor 1934.

⁵⁶ *Po aty*, V. 1935, D. 77, fl. 259-261. Letër e Delegatit të Përhershëm të Shqipërisë në LK, Lec Kurti për Sekretarin e Përgjithshëm të LK, 29 nëntor 1934.

⁵⁷ *Po aty*, V. 1933, D. 493, fl. 106. Lec Kurti drejtuar MPIJ, 2 dhjetor 1934.

pikë, ai shprehu opinionin e tij personal se tani nuk ishte koha për një vizitë të tillë, pasi grekët do ta shfrytëzonin këtë vizitë për interes të tyre, ndërsa në opinionin shqiptar ajo do të kuptohej si një farë cenimi që u bëhej të drejtave të shtetit shqiptar, aq më tepër kur çështja ishte dërguar për shqyrtim në Këshillin e Lidhjes së Kombeve. Kurti e përfundoi fjalën e tij duke deklaruar se “fuqia më e madhe për një shtet të vogël e pa mbrojtje, si shteti ynë, është parashtrimi i së drejtës e i të vërtetës në mënyrë të thjeshtë”. Avenoli pohoi se krijoi përshtypje pozitive nga kjo bisedë⁵⁸. Por, nga ana tjetër, ai nuk mori asnjë angazhim për shqyrtimin e problemeve të minoritetit shqiptar në Greqi.

E gjithë vija e përfaqësuesit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, Lec Kurti gjatë kësaj periudhe kishte qenë: Evidentimi i sakrificave të Shqipërisë, për t’i bërë ballë kërcënimeve të politikës italiane ndaj saj; përpjekjet e qeverisë shqiptare për të pasur marrëdhënie sa më miqësore me fqinjët; përpjekjet për të bindur qarqet e larta të Lidhjes se politika e Greqisë bashkohej me atë të Italisë për sa i përkiste Ballkanit, nga frika që Greqia kishte prej sllavëve (Bullgarisë e Jugosllavisë). Këto qëndrime kishin gjetur simpati në qarqet e Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve, të cilën Mehdi Frashëri e kishte konstatuar kur shkoi në Gjenevë, si tek Sekretari i Përgjithshëm, ashtu edhe tek Drejtori i Seksionit të Pakicave⁵⁹.

Vendimi i dhjetorit 1934 i Këshillit të LK për shqyrtimin e çështjes së shkollave greke u interpretua si një fitore nga qarqet greke. Për këtë arsye legata shqiptare në Athinë sugjeronte që ai të kundërshtohej me këto argumente: 1) Qeveria shqiptare kishte 10 vjet që po i përmbushte detyrimet ndaj Lidhjes së Kombeve, ndërsa qeveria greke po shkombëtarizonte elementin shqiptar në Çamëri, duke i grabitur pasuritë, në mënyrë që ta detyrojë të emigrojë; 2) Komuniteti grekofon në Shqipëri ishte i varfër e nuk mund të paguante mësuesit. Qeveria shqiptare kishte konstatuar se mësuesit paguheshin nga Greqia, e cila synonte të zhvillonte propagandën e asaj politike të vjetër që e kishte zhvilluar në kohën e qeverisë otomane e cila, tashmë kishte vdekur kudo. Natyrisht, kjo propagandë nuk mund të tolerohej e të ringjallej në Shqipëri, sepse po cenonte unitetin kombëtar të saj. Mësuesit që kishte emëruar qeveria

⁵⁸ *Po aty.*

⁵⁹ *Po aty.*

shqiptare, ishin ortodoksë dhe i kishin zhvilluar mësimet në shkolla greke⁶⁰.

Ndërsa Ministria e Jashtme udhëzoi legatën e Athinës të ndiqte një taktikë disi më të ndryshme. Ajo duhej të deklaronte se, qeveria shqiptare i kishte plotësuar në mënyrë maksimale detyrimet kundrejt Gjenevës për mësimin e greqishtes në shkollat greke. Ajo do të priste me bindje vendimin e Këshillit të LK për konfirmimin e të drejtës për emërimin e mësuesve prej saj. Qeveria shqiptare kishte siguruar një barazi të plotë sipas Artikullit 5 të Deklaratës së vitit 1921⁶¹.

Në fillim të dhjetorit, Ministria e Jashtme e udhëzoi përfaqësuesin e saj në Gjenevë që të shmangte me çdo mënyrë dërgimin e një Komisioni Hetimor në Shqipëri nga Sekretari i Lidhjes së Kombeve⁶².

Në fund të vitit 1934, qeveria shqiptare i dha disa shpjegime të tjera shtesë Lidhjes së Kombeve, në të cilat provohej përkushtimi i saj për të zbatuar detyrimet ndërkombëtare lidhur me minoritetin grek në Shqipëri.⁶³ Ajo paraqiti një listë të fshatrave grekofone që kishin një shkollë fillore të rregullt. Këto fshatra kishin 29.929 banorë dhe 54 shkolla. Nxënësit që frekuentuan shkollat e mësipërme gjatë vitit shkollor 1933-1934 ishin 3.692 ndërsa mësuesit e lëndëve mësimore në gjuhën greke ishin 58 veta. Gjithashtu, kishte 39 fshatra grekofone me një popullsi 7.288 banorë që nuk kishin shkolla greke. Këto fshatra kishin nga 100-200 banorë dhe ishin shumë larg njeri-tjetrit. Hapja e një shkolle përbënte një problem të vështirë për t'u zgjidhur. Shumica e mësuesve të lëndëve në gjuhën greke i kishte bërë studimet në gjimnaze apo normale greke.

Ajo njoftonte gjithashtu se dispozitat ligjore parashikonin që arsimi fetar ishte tërësisht i lirë dhe i varur nga dëshira e njerëzve të interesuar të cilët ishin autorizuar të zgjidhnin mësuesit e tyre dhe lokalit e nevojshëm.

⁶⁰ *AMPJ*, V. 1934, D. 144, fl. 118. Legata shqiptare Athinë drejtuar MPJ, 3 dhjetor 1934.

⁶¹ *Po aty*, V. 1934, D. 493, fl. 116. MPJ drejtuar legatës shqiptare në Athinë, 7 dhjetor 1934.

⁶² *Po aty*, V. 1933, D. 493, fl. 122. MPJ drejtuar Lec Kurtit në Gjenevë, Tiranë, 12 dhjetor 1934.

⁶³ *Po aty*, V. 1935, D. 297, fl. 305-306. MPJ e Shqipërisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Tiranë, 21 dhjetor 1934.

Ministria e Punëve të Jashtme publikonte një listë të hollësishme me këto të dhëna⁶⁴:

Mësues të ngarkuar vetëm për lëndë të gjuhës greke që kanë mbaruar shkollën normale greke – 13; që kanë mbaruar liceun grek – 22; që kanë mbaruar gjysmë liceu – 7; që kanë mbaruar shkollën fillore shtesë greke – 15; që kanë mbaruar një shkollë bujqësore – 1.

Për këta mësues, shteti shpenzonte çdo vit 121.000 fr. ari.

Mësimi fetar: ortodoksë – 56; muhamedanë – 2; gjithsej – 58.

Qeveria shqiptare paraqiste edhe një sërë të dhënash krahasuese për zhvillimin e arsimit në zonën e minoritetit, dhe atij në Shqipëri, si dhe për raportet e frekuentimit të shkollave në zonën e minoritetit grek e në Greqi kundrejt popullsisë të cilat i kemi paraqitur në kreun paraardhës. Këto të dhëna krahasuese provonin qartë politikën arsimore korrekte, të sinqertë dhe dashamirëse të qeverisë shqiptare ndaj minoritetit grek në Shqipëri, e cila dallonte shumë nga politikat nacionaliste asimiluese të Greqisë dhe Jugosllavisë ndaj pakicave të tyre dhe në veçanti ndaj asaj shqiptare.

Kështu viti 1934 u mbyll pa arritur një zgjidhje për çështjen e shkollave të minoritetit grek. Ndërsa pritej që zgjidhja të vinte nga një vendim i Këshillit të Lidhjes së Kombeve marrëdhëniet midis Greqisë dhe Shqipërisë mbeteshin të tensionuara.

S u m m a r y

THE QUESTION OF THE GREEK MINORITY SCHOOLS IN 1934

In 1934, when the Albanian government nationalized all private schools, a new dispute with Greece and the Greek minority in Albania began. The nationalization was of a general character and was implemented throughout the country. It aimed at reorganizing the education system on national lines to the exclusion of foreign influences which had negatively effected the fostering of national feelings among Albanian students. Even after the nationalization, the minority schools continued to use the same textbooks, but initially the Greek language classes were reduced.

⁶⁴ *Po aty*, V. 1935, D. 297, fl. 309-310.

The Greek reaction came with the petition of the Greek community addressed to the Secretary General of the League of Nations, complaining about the nationalization of the schools, at the beginning of 1934. In a meeting between the Greek and British ministers in Albania, the former declared that his government would open Albanian schools for the Albanian minority in Chamuria, on the condition that the Albanian government re-established the previous education system as before the nationalization.

The British minister criticized the measures taken by the Albanian government considering them nationalistic in character and not well thought. However, he reported to London that the way Athens was approaching the issue was not to be fully supported as the Greeks had shown no inclination to apply themselves the same principles, they were so energetically insisting on, for the Albanians in Chamuria. The British minister and his government tried to avoid the escalation of the tension between Albania and Greece.

Afterwards, the Albanian government revised several measures of the reform which was obviously undertaken in a hurry and was not well thought. The number of the Greek language classes was restored as before.

The Albanian government presented its arguments to the League of Nations, maintaining that the nationalization had not effected the national character of the Greek minority schools, had not infringed the provisions of the League's Convention and had aimed at establishing a uniform public education system bringing an end to the cultural unrest caused by the old capitulations system, that had turned Albania into a breeding ground for foreign propaganda.

The Albanian government tried to persuade the League of Nations to deal with this question based on the principles of reciprocity, demanding that the Greek government follow the same policy for the Albanian minority in Greece, but did not receive the League's support.

In December 1934 the Council of the League of Nations decided to deal with the question of the Greek minority schools and both parties waited anxiously for the final decisions of the Assembly of the LN. However, the situation remained tense.

